



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1268 Prot.

Tiranë, më 17.11.2021

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTIN E RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, të Vendimit Nr. 1, datë 29.12.2016 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Elbasan", të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan.
2. Akti i Përputhshmërisë lëshohet me kusht që, bashkia në zbatim të Ligjit Nr.91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", t'i njoftojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dokumentin e rishikimit të planit dhe të marrë qëndrimin e saj nëse:
 - i. Është i nevojshëm realizimi i procesit të VSM-së. Në këtë rast bashkia duhet të vijojë me ndjekjen e procedurës përkatëse;
 - ii. Nuk ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të VSM-së.
3. Për rastin sipas shkronjës "i" të pikës 2, bashkia duhet të depozitojë deklaratën mjedisore përpara shqyrtimit dhe miratimit të dokumentit të rishikuar të planifikimit në Këshillin Kombëtar të Territorit.

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT